

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 15<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 67, paragrafët (1), (7) dhe (8) nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23 dhe neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 13 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.ark.01-3632/1 datë 22.08.2025, duke vepruar sipas Kërkesës për pajtim të ndryshim ose plotësim të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ROSA – AB ShKPNjP Shkup, nr.ynë ark.08-1327/2 datë 27.3.2026, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit nr.ark.02-1838/10 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026 miratoi si vijon:

## VENDIM

1. JEPET PËLQIMI për të ndryshuar më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-74 datë 7.9.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ROSA-AB ShKPNjP Shkup, në pjesën që i ferohet:

- strukturës së muzikës së transmetuar siaps zhanreve, domethënë në vend të 100% maqedonase dhe sipas zhanrit muzikë popullore të ndryshme, të transmeton 90% sipas zhanrit muzikë argëtues të ndryshme dhe 10% sipas zhanrit muzikë popullore të ndryshme dhe në
- strukturën e muzikës sipas gjuhës, domethënë në vend të 100% në gjuhën maqedone, struktura e muzikës sipas gjuhës të jetë 87% në gjuhën angleze, 8% në gjuhën maqedone dhe 5% gjuhë të tjera.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

## Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ROSA-AB ShKPNjP Shkup (RADIO ROSA), është zotërues i Lejes për transmetim në radio PA1 nr.08-74 datë 7.9.2023, me vlefshmëri deri më 4.1.2027 për transmetim në nivel rajonal, shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedone.

Në pajtim me nenin 67, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), format i shërbimit programor të transmetuesit (i përgjithshëm ose i specializuar) dhe udhëzime themelore esenciale për punën e transmetuesit, janë përcaktuar në konceptin programor. Transmetuesi është i detyruar për të zbatuar së paku 80% të konceptit programor të përcaktuar në lejen e dhënë gjatë një jave. Për ndryshim ose plotësime të konceptit programor në bazë të të cilit transmetuesi ka marrë lejen për transmetim televiziv ose radio, për më shumë se 20%, transmetuesi duhet të marrë miratim paraprak nga Agjencia. Kërkesa për dhënien e pëlqimit dorëzohet në formularin e përgatitur nga Agjencia dhe publikohet në ueb-faqen e saj. Koncepti programor në bazë të të cilit transmetuesi ka marrë lejen për transmetim televiziv dhe radio, si dhe ndryshimet ose plotësimet publikohen në ueb-faqen e Agjencisë (neni 67 paragrafët 6, 7 dhe 8 të LShMAAV).

Sipas Rregullores për formatet e shërbimit programor të transmetuesit nr.ynë ark.01-5776/1 datë 21.11.2014, radio folëse muzikore me format të përgjithshëm (siç është formati ekzistues i shërbimit programor të RADIO ROSA) duhet të përmbajë mbi 5% deri në 15% përmbajtje me fjalë

<sup>1</sup>Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.248/18).

në total të programit të transmetuar gjatë një jave. Plotësuese, muzika e transmetuar duhet të jetë e llojeve dhe zhanre muzikore të ndryshme..

Sipas konceptit programor që është pjesë përbërëse e Lejes për transmetim në radio PA1 nr.08-74 datë 7.9.2023, pjesëmarrja në përmbajtjet me fjalë në totalin e programit të transmetuar gjatë një jave tek RADIO ROSA duhet të jetë 5.40%, në total të muzikës së transmetuar gjatë një jave duhet të përbëhet nga zhanre të ndryshme të muzikës popullore dhe të transmetohet në gjuhën maqedone.

Më 27.3.2026, RADIO ROSA, në pajtim me nenin 67, paragrafi (7) të LSHMAAV, të formularit të përcaktuar, është paraqitur Kërkesë për pajtim për ndryshim ose plotësime të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio nr.y në ark.08-1327/1 datë 27.3.2026, për ndryshimin e konceptit programor në lidhje me strukturën e transmetimit të muzikës sipas zhanreve dhe gjuhës. Nga ana e transmetuesit, është shpjeguar se arsyet për ndryshimin e kërkuar të konceptit programor ishte nevojë për përshtatjen ndaj trendeve bashkëkohore mediatike, realiteteve ekonomike dhe ndryshimit të shprehive të dëgjuesve, me qëllim që radioja të mbetet konkurente, relevante dhe e qëndrueshme në treg.

Pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë nga RADIO ROSA, sektori kompetent konstatoi se transmetuesi sërish do të jetë brenda kornizës së parashikuar me Rregulloren për formatet e konceptit programor të transmetuesve për radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, sepse pjesëmarrja e përmbajtjeve me fjalë në total të transmetimit të programit gjatë javës do të mbetet mbi 5% deri më 15%, dhe muzika e transmetuar do të jetë në kuadër të kërkesës që të përbëhet nga lloje dhe zhanre të ndryshme muzikore (do të transmeton muzikë popullore dhe argëtuese e zhanreve të ndryshme).

Njëkohësisht nga sa më sipër, dhe duke marrë parasysh se Kërkesa për pajtimin e ndryshimit ose plotësimit të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio nga RADIO ROSA (nr.y në ark..08-1327/1 datë 27.3.2026) është në pajtim me nenin 67, paragrafi (7) të LShMAAV, dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë drejtuar Këshillit të Agjencisë dorëzoi Propozim PA1 nr.08-1327/3 datë 22.4.2026, për miratimin e vendimit me të cilën jipet pajtim për ndryshim të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-74 datë 7.9.2023 të RADIO ROSA, në pjesën që i referohet strukturës së transmetimit të muzikës sipas zhanreve dhe gjuhës, përkatësisht në vend të 100% program me muzikë popullore të zhanreve të ndryshme në gjuhën maqedone, të transmeton 90% sipas zhanrit muzikë argëtuese të ndryshme dhe 10% sipas zhanrit muzikë popullore të ndryshme dhe sipas gjuhës, në vend të 100% në gjuhën maqedone, struktura e muzikës sipas gjuhës të jetë 87% në gjuhën angleze, 8% në gjuhën maqedone dhe 5% në gjuhë të ndryshme.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 15 të LSHMAAV, në pajtim me nenin 67, paragrafët (1), (7) dhe (8) nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23 dhe neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 13 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, duke vendosur sipas Kërkesës për pajtim të ndryshimit ose plotësimit të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio nga shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ROSA – AB ShPKNJ P Shkup, nr.y në ark.08-1327/2 datë 27.3.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-1838/10 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim si në dispozitiv. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Saho Stefanovski**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse është i pakënaqur, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të paraqesë padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

Përktheu: Antoneta Shabani